

Datë 01.02.2024

MEMO

Drejtuar: Z. Arben Pëllumbi
Kryetar i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Për dijeni: Komisioni për Çështjet Europiane

Lënda: Për domosdoshmërinë e kalimit të projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura" për shqyrtim te Komisioni për Çështjet Europiane

I nderuar Z. Arben Pëllumbi,

Ne, organizatat e shoqërisë civile të gjithë të dedikuar në zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtjen e biodiversitetit dhe në veçanti të Zonave të Mbrojtura në Shqipëri, dëshirojnë të shprehin shqetësimet serioze për sa i takon projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", të propozuar nga një grup prej 12 deputetësh të maxhoransës.

Ndërsa vazhdojmë të ndjekim ngushtësisht e me vëmendje këtë process si dhe duke vlerësuar emegjencën në afatet e lënë për konsultim publik deri më 15 Shkurt që është caktuar seanca plenare mbi këtë projektligj.

Në vijim të komenteve specifike dhe përmirësimeve të nevojshme që janë dërguar/dhënë në platformën online të konsultimit publik dhe gjatë dëgjësës së parë publike online me shoqatën AOS, shqetësimet tona gjithashtu referohen edhe me kufizimin e këtij projektligji për diskutime vetëm në dy komisione: Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Ne vlerësojmë jashtëzakonisht të rëndësishme nevojën që ky projektligj të zgjerohet për diskutim e shqyrtim edhe në komisionet e tjera e me fokus Komisionin për Çështjet Europiane, sepse ky projektligj ka nevojë të përafrimit të ligjit me kuadrin ligjor të Bashkimit Europian, me Direktivat, rregulloret e parimet ndërkombëtare si IUCN dhe Konventat në të cilat bëjmë pjesë dhe jemi të ratifikuar si vend.

Kjo nevojë diktohet nga të paktën dy arsye:

- (1) Projektligji propozon ndryshime në Ligjin për Zonat e Mbrojtura, ndërsa ky i fundit është përafuar me aquis Communautaire, për pasojë çdo ndryshim i tij duhet të kalojë njësoj procesin e përafrimit.
- (2) Projektligji për nga përmbajtja e tij cënon parimet e IUCN, siç gjenden të argumentuara në letrën drejtuar deputetëve të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të cilën e gjeni bashkalidhur.

Duke pasur parasysh shqyrtimin e ardhshëm të ndryshimeve të propozuara për 'Ligjin për Zonat e Mbrojtura' të planifikuar për seancë plenare në **Kuvend më 15 Shkurt 2024**, ne kërkojmë shtyrjen e diskutimit së seancës plenare dhe kalimin për diskutim të këtij projektligji në Komisionin e Çështjeve Europiane.

Ne kemi besim në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj dhe shprehim mirënjohjen tonë paraprakisht!

Me vlerësim,

Organizatat:

1. Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë (AOS)
2. Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (EcoAlbania)
3. Qendra Res Publica
4. Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA Shqipëri)
5. Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri (REC Shqipëri)
6. Shoqata Impetus
7. Qendra për Fuqizimin Ligjor (CLE)
8. Milieukontakt Albania
9. Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN)
10. Organizata Impetus
11. Qendra Uja
12. CELIM Shqipëri
13. ILIRIA
14. DMO Albania (Destination Management organization)
15. ALL GREEN
16. GAIAAlbania
17. H2H Foundation
18. ALBAFOREST CENTRE
19. Hellenic Ornithological Society/Birdlife Greece
20. Qendra KUJRI
21. Grupi ATA
22. Studio G & G Group
23. River Clean Up Albania
24. VIS Albania
25. COSV në Shqipëri
26. Co-PLAN Institute for Habitat Development
27. SHERM Albania
28. Rrjeti i Profesionistëve të Rinj

KËRKESË

DREJTUAR: Z.
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

KËRKUES: Organizata Mjedisore, Ekspertë dhe Staf Akademik i Institucioneve të Arsimit të Lartë

LËNDA: Shqetësime Rreth Draft Amendimeve të Ligjit për Zonat e Mbrojtura

I Nderuar Z.

Së pari shpresojmë që kjo letër t'ju gjejë mirë me shëndet dhe punë.

Ne, përfaqësojmë një grup organizatash dhe ekspertësh të fushave të ndryshme, të gjithë të dedikuar në zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtjen e biodiversitetit dhe në veçanti të Zonave të Mbrojtura në Shqipëri. Organizatat tona, përkrah ekspertëve mjedisorë dhe ligjorë, dëshirojnë të shprehin shqetësimet serioze për sa i takon draftit për amendimin e ligjit për Zonat e Mbrojtura, të propozuar nga deputetët iniciatorë. Ndërsa komentet specifike dhe përmirësimet e nevojshme do t'ju shprehen gjatë dëgjësive publike, shqetësimet tona parimore e të përgjithshme janë shprehur më poshtë:

- 1. Projektligji është në kundërshtim me parimet e IUCN në procedurat e draftimit të ligjeve mjedisore.** Analiza jonë e thelluar, tregon se projektligji nuk është në përputhje me principet e parashikuara nga Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN), duke filluar nga përkufizimi i IUCN që parashikon se legjislacioni për zonat e mbrojtura duhet të theksojë qartë se vetëm ato zona ku objektivi kryesor është ruajtja afatgjatë e natyrës dhe e shërbimeve të ekosistemit përkatës, njihen si zona të mbrojtura brenda sistemit formal. Parimet e IUCN përcaktojnë gjithashtu pa ekuivok, se legjislacioni i zonave të mbrojtura nuk duhet të përdorë aplikimin dhe përcaktimin e kategorive të zonave të mbrojtura për të ulur nivelin e mbrojtjes së mjedisit dhe për të justifikuar zhvillime me pandjeshmëri mjedisore në këto zona. Kjo mospërputhje ngjall shqetësime të thella në lidhje me impaktet negative në biodiversitet dhe ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe integritetin e përgjithshëm të Zonave të Mbrojtura.
- 2. Projektligji sjell regres të drejtash nga mbrojtja ligjore aktuale që gëzojnë sot Zonat e Mbrojtura.** Ligji aktual ka nevojë për përmirësim dhe përsosje në drejtime dhe dispozita që do t'i trajtojmë më poshtë. Megjithatë, projektligji i depozituar në Kuvend sjell përkeqësim të të drejtave të fituara për garantimin e mbrojtjes së biodiversitetit sipas ligjit aktual. Në

fuqimisht besojmë se amendimet duhet të përmirësojnë dhe forcojnë mbrojtjen e dhënë këtyre zonave dhe jo ta përkeqësojnë ato.

3. **Projektligji ka anshkaluar ekspertizën që i nevojitet draftimit, përpara diskutimit në nivel politik/parlamentar.** Urgjenca me të cilën ky projektligj po kalon procedurat parlamentare, duke nisur nga mënyra e prezantimit të tij, deri në diskutimet në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, ngre shqetësime serioze. Ky nxitim pa diskutim do të kompromentojë cilësinë e procesit ligjvënës. Ne besojmë se çështje me rëndësi të madhe për pasuritë tona natyrore kërkojnë një proces vetingu, gjithëpërfshirës, të mirëkonsultuar, ku të gjitha implikimet të konsiderohen me kujdes. Natyra komplekse e legjislacionit të mjedisit ka nevojë për një vlerësim të shumëanshëm, ku të përfshihet ekspertiza në nivel teknik dhe konsultimi i gjerë me institucionet shkencore, organizatat mjedisore dhe me aktorë të tjerë që përfaqësojnë interesa të ndryshme, përpara se të diskutohet në nivel politik, standart ky i percaktuar edhe nga Udhezuesit e IUCN.

4. **Ligji aktual ka nevojë për amendime në të gjithë përmbajtjen e vet, dhe ky projektligj nuk i përgjigjet kësaj nevojë.** Pas një vlerësimi të kujdeshëm që i kemi bërë ligjit aktual kemi arritur në konkluzionin që ky ligj ka nevojë për përmirësime dhe amendime në të gjithë gjatësinë e tij. Ne konstatojmë se ligji aktual i zonave të mbrojtura ka nevojë për një rishikim tërësor e sidomos në frymën e përafrimit me Direktivat Europiane të Habitaveve dhe të Shpendëve. Po kështu ligji ka nevojë për:
 - rishikim e saktësim të përkufizimeve (Neni 3);
 - saktësim të formës së kombinuar të administrimit/menaxhimit të një ZM-je (Nenet 8, 38, 39);
 - rishikim të hapave për shpalljen e ZM-ve (Nenet 10, 12);
 - sqarim të terminologjisë lidhur me planin specifik, planin e administrimit të rrjetit ekologjik dhe planin kombëtar të ZM-ve (Nenet 5, 10);
 - saktësim të nevojës ose jo të ndërmarrjes së vlerësimit të ndikimit në mjedis apo të një vlerësimi tjetër në rast të shpalljes së Zonës së Mbrojtur (Nenet 10, 35, 36);
 - rishikim me qëllim forcimin e rregullave për heqjen apo ndryshimin (reduktimin) e sipërfaqes dhe statusit të Zonës së Mbrojtur (Nenet 35, 36);
 - përshtatje më të mirë të sistemit tonë të nënzonimit me atë të IUCN-së, shtimit të kriterëve për zonat e mbrojtura me interes kombëtar, shmangies së përsëritjeve (Nenet 13, 33, 47, 48, 49, 50, 56);
 - rishikim harmonizues dhe saktësues i disa kategorive të menaxhimit, me përcaktimet për nënzonat dhe aktivitetet (Nenet 16, 19, 23, 24, 47, 48, 49)
 - plotësim të dispozitave për zonat me interes ndërkombëtar dhe ato me interes për BE, për rritjen e përafrimit me Direktivën e Habitaveve dhe përafrim me Direktivën e Shpendëve (Nenet 26, 29).
 - Etj.

Nisur nga komentet e mësipërme, ne mendojmë se miratimi me nxitim i amendimeve vetëm sipas projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura:” të depozituar nga një grup deputetësh, do të bëhet pengesë për përmirësimin e shpejtë, të domosdoshëm dhe afatgjatë të ligjit për zonat e mbrojtura.

Nisur nga sa me sipër, Ne, advokojmë për rishikimin e plotë të të gjithë ligjit për zonat e mbrojtura. Veç kësaj, kompleksiteti i legjislacionit mjedisor kërkon që procedura e miratimit të tij të kalojë me propozim të Ministrisë përkatëse të Mjedisit, ku të diskutohet në nivel Teknik, gjë të cilën mund ta sigurojë vetëm specialistët përkatës të fushave të ndryshme. Bashkëpunimi nga një grup ekspertësh do të mundësojë identifikimin e boshllëqeve ligjore, do të mundësojë që amendimet të jenë në linjë me praktikat ndërkombëtare më të mira e sidomos ato të Bashkimit European dhe IUCN-së. Amendimet duhet të përfshijnë konsultim të gjerë me grupet e interesit të drejtimeve të ndryshme, që përfshijnë organizata mjedisore, komunitete lokale dhe ekspertë të mbrojtjes së mjedisit ekspertë ligjorë etj. Kjo qasje përfshirëse do të sigurojë që ligji i ndryshuar të reflektojë konsiderata të balancuara të prespektivave të ndryshme, që synojnë zhvillimin e qëndrueshëm.

Në dritën e gjithë parashtrimit tonë, ju kërkojmë mirësisht të rivlerësoni shpejtësinë me të cilën po ecën procedura e diskutimeve parlamentare dhe të pezulloni atë. Ne propozojmë që amendimet të kalojnë nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit si një qasje më e matur ku të përfshihen kontributi dhe bashkëpunimi i ekspertëve të ndryshëm, konsultimin me grupet e interesit dhe të garantohet transpozimi i plotë i Direktivave të Bashkimit European (Habitat dhe Shpendëve) si dhe respektimi i parimeve të IUCN-së.

Ne vlerësojmë vëmendjen tuaj për këtë çështje dhe mbetemi në pritje të mundësisë për të diskutuar shqetësimet tona më tej. Organizatat tona si dhe ekspertët tanë janë të gatshme për t’u angazhuar në diskutime konstruktive për të siguruar që çdo ndryshim ligjor në fund të fundit t’i shërbejë interesave më të mira të mjedisit dhe të gjithë shoqërisë.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin dhe mbetemi besimplotë në bashkëpunimin me ju.

Sinqerisht,

Tiranë, më 22.12.2023